

**Partia Demokratike e Shqipërisë**  
**Komisioni i Apelit, Integritetit dhe Etikës**

**VENDIM**  
**I Shkurtuar**  
**Numër 1, datë 26.07.2023**

Komisioni i Apelit Integritetit dhe Etikës, i kryesuar nga Kryetarja Flutura Açka, në seancën e datës 26.07.2023 mori në shqyrtim çështjen me

**KËRKUES:** Kryesia e Partisë Demokratike të Shqipërisë, përfaqësuar nga Indrit Sefa, sipas vendimit numër 17, datë 25.03.2023. (në mungesë)

**PERSON I INTERESUAR:** Gazment Bardhi, Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë).

**OBJEKTI:**

1. Shqyrtimin e përputhshmërisë së vendimit të Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë Demokratike numër 59 prot, datë 22.07.2023 me titull “Për thirrjen e mbledhjes së Këshillit Kombëtar të Partisë Demokratike të Shqipërisë”.
2. Shfuqizimin e këtij vendimi si një akt në kundërshtim me dispozitat statutore.

**BAZA LIGJORE:** Neni 54, pika 4 të Statutit të Partisë Demokratike.

Komisioni pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga Kryesia e Partisë Demokratike e përfaqësuar nga përfaqësuesi Indrit Sefa vlerëson se:

- Sekretari i Përgjithshëm nuk ka tagrin të përcaktojë një rend dite, në rastin e thirrjes së mbledhjes së Këshillit Kombëtar sipas pikës 4 të nenit 46, të ndryshëm nga “Komandimi i Nënkrjetarit në detyrën e Kryetarit të Partisë”.
- Rendi i ditës i mbledhjes së Këshillit Kombëtar, të thirrur nga Sekretari i Përgjithshëm, sipas pikës 4 të nenit 46 nuk mund të ketë asnjë pikë të ndryshme dhe më shumë se Komandimi i Nënkrjetarit në detyrën e Kryetarit të Partisë.
- Dorëheqja nuk është një akt që mund të merret në shqyrtim apo të miratohet pasi marrja në shqyrtim apo miratimi i saj nënkupton mungesën e vakancës që është parakushti kryesor për thirrjen e mbledhjes së Këshillit Kombëtar sipas pikës 4 të nenit 46.
- Votimi për marrjen e vendimit për komandimin e Nënkrjetarit në detyrën e Kryetarit bëhet me procedurën e votimit të fshehte. Mbledhja online e Këshillit Kombëtar shkel parimin e fshetësisë së votës e për pasojë kjo procedurë është e papajtueshme me Statutin e Partisë.
- Nga burimet arkivore aktet dhe rrethanat e marra në shqyrtim nuk rezultojnë se Rregullorja e Brendshme për Organizimin dhe Funkcionimin e Këshillit Kombëtar nuk rezultojnë të jetë një dokument i miratuar nga Këshilli Kombëtar. Për pasojë kjo Rregullore nuk ka fuqi juridike dhe nuk mund të jetë një akt mbi të cilin të mund të bazohet zhvillimi online i mbledhjes së Këshillit Kombëtar

Vendosi:

- Pranimin e kërkesës së kërkuesit Kryesia e Partisë Demokratike të Shqipërisë.
- Shfuqizimin e vendimit numër 59, datë 22.07.2023 të Sekretarit të Përgjithshëm me titull “Për thirrjen e mbledhjes së Këshillit Kombëtar të Partisë Demokratike të Shqipërisë” si një akt absolutisht të pavlefshëm e në kundërshtim me Statutin e Partisë Demokratike.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
- Vendimi i njoftohet Kryesisë së Partisë Demokratike, Sekretarit të Përgjithshëm Gazment Bardhi dhe anëtarëve të Këshillit Kombëtar.

Kryetare

Flutura Acka